



Komiteti për Komunitete  
02. Nr. VII  
Deçan, dt. 12.07.2024

## PROCESVERBAL

Mbledhja e shtatë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 12.07.2024.  
Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, KFOR-i.  
Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport nga ZLK;
3. Ftesë Drejtorisë Komunale për Arsim, lidhur me temën: regjistrimi i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme si dhe numri i nxënësve që kanë braktisur shkollimin e rregullt nga komuniteti jo shumicë.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për periudhën Janar-Qershor 2024.
5. Të ndryshme.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.  
Procesverbali miratohet njëzëri, pa vërejtje.

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: z. Shaban Pejçinović, kordinator i ZKK-së, raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar.

Si një lajm të mirë për këtë periudhë të raportimit vlen të ceket se ka përfunduar asfaltimi i rrugës në fshatin Prapaçan në lagjen ku banojnë komuniteti Boshnjak.

III. Raport nga Drejtoria Komunale për Arsim:

Sa i përket raportit nga Drejtoria Komunale për Arsim z. Ramiz Bajramaj zyrtar pran kësaj drejtorie theksoj se jemi në përfundim të procesit mësimor, raportet nga shkollat ende si kemi marr sapo ti marrim do i prezantojmë ne takimin e radhës. Regjistrimi i nxënësve po behet në të gjitha nivelet nëpër shkolla pa asnjë problem.

Sa i përket rasteve të braktisjes së nxënësve nga komuniteti jo shumicë këtë vit kemi pas dy raste nga komuniteti Egjiptian, i kemi marrë të gjitha veprimet e nevojshme që nga ekipet për parandalimin e braktisjes së shkollimit të rregullt neper shkolla deri tek instancat më të larta Komunale por pa sukses.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit për komunitete nga LDK kërkoj nga drejtoria përkatëse të behet më shumë në këtë aspekt dhe të evitohen këto raste të braktisjes së shkollimit të detyrueshëm.

IV. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për periudhën Janar-Qershor 2024.

Pas prezantimit nga Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z, Shkelzen Berisha u miratua njëzëri, pa vërejtje.

V. Të ndryshme.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit për komunitete nga LDK kërkoj nga Shaban Pejçinoviç, kordinator i ZKK-së që të shënohen festat e komuniteteve me ndonjë aktivitet simbolik.

Shaban Pejçinoviç e informoj se në mungesë të buxhetit për këtë vit nuk do të mund të realizojnë ndonjë aktivitet porse shpresojnë se viteve në vazhdim do të kenë buxhet të mjaftueshëm për shënimin e këtyre aktiviteteve.

E veçante e këtij takimi ishte se nën organizimin e OSBE-së me qëllim të shkëmbimit të përvojave të punës pjesëmarrës në këtë takim ishin anëtarët e Komitetit për Komunitete nga Komuna e Pejës. Te njëjtit u ndanë të kënaqur me këtë takim dhe shprehën dëshirën që ky lloj bashkëpunimi të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Edmond Dushi përfaqësues nga OSBE propozoj që takimi i ardhshëm në mes të përfaqësuesve të dy zyrave përkatëse të mbahet në Pejë gjatë muajt shtator.

Kryesuesi i falënderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:

Artan Ismajlaj



Kryesuesi i mbledhjes:

Shkelzen Berisha

